

# Ankimet në grup dhe ankuesit e shumëfishtë

Kur një ankues apo një përfaqësues dorëzon ankesa në emër të dy apo më shumë ankuesve, ankimet e të cilëve bazohen mbi fakte të ndryshme, duhet të plotësohet një formular ankimi i veçantë për secilin individ, duke dhënë të gjithë informacionin e kërkuar. Dokumentet që kanë lidhje me secilin ankues duhet të bashkëngjiten në formularin e ankimit të atij individ.

Kur ka më shumë se 10 ankues, përfaqësuesi duhet të dorëzojë, përveç formularëve të ankimit dhe dokumenteve, edhe një tabelë e cila përcakton detajet e identifikimit të secilit ankues.

## ■ Table

Kur përfaqësuesi është avokat/jurist, kjo tabelë duhet t'i sigurohet Gjykatës, po ashtu, në formë elektronike (në një CD-ROM apo memory stick).

Në rastet e grupeve të mëdha të ankuesve apo ankimeve, ankuesit apo përfaqësuesit e tyre mund të udhëzohen nga Sekretaria e Gjykatës që të sigurojnë një tekst të parashtresave apo dokumenteve të tyre me anë të mënyrës elektronike ose në ndonjë formë tjetër. Nga Sekretaria e Gjykatës mund të jepen edhe udhëzime të tjera mbi hapat e kërkuar që do të lehtësojnë përpunimin efektiv e të shpejtë të ankimeve.

Mospërmbushja e udhëzimeve të Sekretarisë së Gjykatës lidhur me formën apo mënyrën me të cilën dorëzohen ankimet në grup ose ankimet nga ankuesit e shumëfishtë, mund të rezultojë në faktin që çështjet nuk do t'i përcillen Gjykatës për shqyrtim (shihni nenin 47 § 5.2 të Rregullores).

